



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 348/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren, - Bilgin Opoya, vëzhgues, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) – Kryesusit të vendvotimit, për shkak të përjashtimit nga vendvotimi, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.348/2019 e datës 07.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren - Bilgin Opoya, vëzhgues, kundër Kryesuesit të vendvotimit 2004A/01R, me të cilën ka kërkuar që të verifikohet procesi i votimit, për shkak të përjashtimit të ankuesit nga vendvotimi 2004/01R.

A r s y e t i m

Me datë 07.10.2019, subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), përkatësisht Bilgin Opoya vëzhgues i këtij subjekti ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.348/2019, me të cilën pretendon se në Prizren në qendrën e votimit 2004A/01R, më kanë ndaluar të monitoroj – vëzhgoj procesin e votimit. Unë kam qenë vëzhgues i subjektit KDTP në Prizren dhe komisioneri më ka ndaluar hyrjen në klasë. Me anë të kësaj ankese kërkon që të hetohet ky proces. Si provë ankësës i ka bashkangjitur dokumentin e identifikimit të vëzhguesit.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e pengimit të tij që të vëzhgoj procesin e votimit, dhe nuk e ka dëshmuar në ankesën e tij se a ka qenë vëzhgues i akredituar për zgjedhjet e datës 06.10.2019.

Ndërsa menaxheri i Qendrës së Vendvotimit në përgjigje në ankesë të datës 09.10.2019 thekson se nuk janë të sakta fare pretendimet e paraqitësit të ankësës sepse i njejtë nuk ka qenë i pajisur me begjin e vëzhguesit dhe gjatë tërë ditës ka qëndruar jashtë, në korridor (këtë mund ta vërtetojmë edhe me anë të incizimeve të kamerave të shkollës), dhe asnjëherë gjatë gjithë ditës nuk na janë afruar neve si staf menaxhues për tu ankuar për një gjë të tillë.

Sipas kërkesës së PZAP-it, në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2019, Nystret Bytyqi i ZLKZ-së, në Prizren deklaroi se në rastin e ankesës Anr.348/2019, në Qendren e Votimit të cekur në ankesë, unë si zyrtar Komunal nuk kam pranuar asnjë ankesë apo informatë mbi këtë dhe nuk më është raportuar për këtë rast.

Po ashtu, sipas kërkesës së PZAP-it, me datë 08.10.2019 është përgjigjur edhe znj. Sevim Budak – kryesuese, e cila deklaroi se nuk e pranoi këtë ankesë për arsye se unë nuk kam qenë komisionere/kryesuese në klasën 2004/A 01/R, por në klasën 2004/A 03/R.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me përjashtimin që ju është bërë nga kryesuesi i vendvotimi 2004/08D, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli duke u mbështetur edhe në përgjigjet e KQZ-së, ZLKZ-së, nuk mundi të konstatojë faktin se ankuesi, është përjashtuar nga Vendvotimi 2004/01R, siç pretendohet në ankesë.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), përkatësisht vëzhguesit, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e në procesin e votimit me datën 06.10.2019, në Vendvotimi 2004/01R.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.348/2019 më datën 10.10.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.